



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

VENDIM

Nr. 6121 prot

Ballsh më 16 / 12 / 2025

Nr. 13 datë 16 / 12 / 2025

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB Nr.12 datë 24.02.2020, Neni 22, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 16 / 12 / 2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 23 / 12 / 2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(_____)

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(_____)

Kryetari i Këshillit Bashkiak

(Handwritten signature)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK MALLAKASTËR

Nr. 6121 / prot.

Ballsh më 16.12.2025

Lënda: Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkisë Mallakastër.

- ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

Për dijen: KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, shkronja "a", në mbështetje të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak, dhe mbledhjes së mbajtur nga kryesia e këshillit, njoftoheni se mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Mallakastër do të mbahet në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë ditën Martë, datë **23.12.2025, ora 13:00**, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 21.11.2025.
3. **Projektvendim Nr.45:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr.46:** Për miratimin e listës së përfituesve të bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin shkollor 2025-2026.
5. **Projektvendim Nr.47:** Për miratimin e listës së përfituesve të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026.
6. **Projektvendim Nr.48:** Për miratimin e pagës së punonjësve mësimor efektiv (instruktur) në shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët që kryejnë orë mësimi shtesë, Bashkia Mallakastër.
7. **Projektvendim Nr.49:** Për miratimin e performancës të vitit 2025.
8. **Projektvendim Nr.50:** Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe të buxhetit vjetor 2027.
9. **Projektvendim Nr.51:** Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mallakastër dhe institucioneve në varësi për vitin 2026.
10. **Projektvendim Nr.52:** Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026.

11. Projektvendim Nr.53:Për miratimin e buxhetit të vitit 2026, dokumentit përfundimtar të projektbuxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve.

12. Projektvendim Nr 54:Për miratimin e financimit të ndarë në tre vite.

Mbledhja e komisioneve: për pikat 3,6,10,11 Komisioni i Ekonomisë; për pikat 4,5,6 Komisioni i Arsimit dhe për pikat 7,8,9 Komisioni Juridik.

KRYETAR KËSHILLI

Nexhmi Sulaj

